



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 4 shtator 2017  
Nr. ref.:RK 1121/17

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI17/17**

Parashtrues

**Alfred Bobaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pzl. nr. 182/16,  
të 30 janarit 2017**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Alfred Bobaj, nga fshati Korishë, komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin [Pzl. nr. 182/16] e Gjykatës Supreme, të 30 janarit 2017, në lidhje me Vendimin PAKR. nr. 87/16 të Gjykatës së Apelit, të 15 marsit 2016 dhe Aktgjykimin [P. nr. 82/15] e Gjykatës Themelore në Prizren, të 5 janarit 2016.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës konkretisht nuk specifikon se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) pretendon t'i janë shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Megjithatë, vet esenca e kërkesës së parashtruesit ka të bëjë me gjykim të drejtë, e që është e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 21 shkurt 2017, parashtruesi parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 28 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 5 korrik 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 21 maj 2008, ka ndodhur një tentim grabitje e cila përfundoi me vdekje.
10. Më 29 janar 2014, për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi e ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 147, paragrafi 1, nënparagrafi 7 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës, Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda ngriti aktakuzën PP. nr. 4/2013.

11. Gjatë shqyrtimit në Gjykatën Themelore, Prokurori i Shtetit ka dhënë propozimin për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Në bazë të shkresave të lëndës rrjedh se këtë propozim e kanë mbështetur mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari.
12. Më 31 dhjetor 2015, është mbajtur shqyrtimi në Gjykatën Themelore për marrëveshjen për pranimin e fajësisë në praninë e të gjitha palëve në procedurë, ku marrëveshja është pranuar edhe zyrtarisht nga Gjykata Themelore.
13. Më 5 janar 2016, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [P. nr. 82/2015] me të cilin e shpalli parashtruesin fajtor për veprën penale dhe i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vitesh, në të cilën llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.
14. Në arsyetimin e Aktgjykimit [P. nr. 82/2015], Gjykata Themelore parashtroi: *“Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, duke pas për bazë edhe rekomandimet e dhëna në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të neneve 73 dhe 74 të KP dhe prej rrethanave rënduese në anën e të akuzuarit (sepse bëhet fjalë për recidivistin i cili ka qenë i dënuar për vepra penale edhe më parë) gjykata vlerësoi shkallën e rrezikut shoqëror dhe vlerës së mbrojtur, si dhe rrethanat lehtësuese ...”.*
15. Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës - Departamentin për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) për shkak të lartësisë së dënimit i cili i është caktuar, me propozim që aktgjykimi i Gjykatës Themelore të ndryshohet, ashtu që atij t'i shqiptohet dënimi më i vogël se sa dënimi i dakorduar me marrëveshjen për pranimin e fajësisë.
16. Gjithashtu, Prokuroria e Apelit paraqiti përgjigje në ankesën e parashtruesit, në të cilën propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar.
17. Më 15 mars 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [PAKR. nr. 87/16], me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të palejuar, me arsyetim se: *“Në marrëveshje të parashtruar me shkrim para gjykatës, ndër të tjerat, palët kanë paraparë po ashtu edhe dispozitën e cila ka paraparë kufijtë e shqiptimit të dënimit për veprat penale për të cilat të akuzuarit kanë pranuar fajësinë - kuptohet në bazë të marrëveshjes për pranim fajësie, ku palët janë pajtuar edhe për kufijtë e dënimit, ashtu që dënimi që do t'iu shqiptohet nga gjykata të jetë dënimi me burg në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjetëve...”.*
18. Parashtruesi paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me arsyetim se: *“... pasi që aktgjykimi ka marrë formën e prerë, janë paraqitur rrethana të reja të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit, e të cilat do të mund të ndikonin në lartësinë e dënimit ...”.*
19. Më 30 janar 2017, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin [Pzd. nr. 182/2016], me të cilin e refuzoi kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit si të pabazuar, me arsyetim se: *“Kjo Gjykatë vlerëson se rrethanat e cekura në*

*kërkesë, përkitazi me gjendjen e përgjithshme ekonomike të familjes, mund të konsideroheshin si rrethana të reja të cilat nuk janë vlerësuar me rastin e matjes së dënimit. Mirëpo, ato nuk janë të asaj natyre të cilat justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke pasur parasysh peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të dënuarit e në veçanti mënyrën e kryerjes së veprës penale”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat nuk i kanë marrë parasysh rrethanat e reja të cilat do të mund të ndikonin në lartësinë e dënimit dhe se ato kanë qenë të njohura në momentin e shqiptimit të lartësisë së dënimit me burgim.
21. Parashtruesi kërkon nga Gjykata: *“(…) ta kthejë lëndën në rigjykim që nga fillimi”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*(…)*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

24. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; kërkesa është parashtruar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
25. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili thotë:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

26. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

d) *kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

(2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.*

27. Gjykata rikujton se parashtuesi nuk ka treguar se cilat të drejta i janë shkelur drejtpërdrejtë me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme; mirëpo, parashtuesi në kërkesë ka theksuar se *“gjykatat nuk i kanë marrë parasysh rrethanat e reja të cilat do mund të ndikonin në lartësinë e dënimit”* që ngre çështjen e garancive të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
28. Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
29. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka përcaktuar se *“është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale”* (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I.)
30. Gjykata, gjithashtu, përsërit se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore, prandaj ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (Shih, GJEDNJ, rasti *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, të 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; shih, po ashtu, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti KI86/11, parashtuesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, të 5 prillit 2012).
31. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se në procedurën e vërtetimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore të parashtuesit do t’u përmbahet parimeve të përcaktuara me praktikën e GJEDNJ-së, sipas së cilës: *“drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi* (GJEDNJ, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimin i 6 dhjetorit 1988, seria A, numër 146, paragrafi 68).”
32. Rrjedhimisht, në rastin konkret Gjykata vëren se Prokuroria Speciale i propozoi parashtuesit marrëveshjen për pranimin e fajësisë për veprën penale për të cilën ai është dyshuar se e ka kryer, me të cilën marrëveshje janë pajtuar

- ai dhe mbrojtësi i tij, e këtë Gjykata e konstatoi në bazë të shqyrtimit të shkresave të lëndës.
33. Më tej, Gjykata vëren se të gjitha palët në procedurë kanë qenë të njoftuara me vetë përmbajtjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, si dhe me kufizimet dhe kushtet të cilat një marrëveshje e tillë i bartë me vete.
  34. Gjithashtu, Gjykata vëren se të gjitha palët në procedurë kanë pasur mundësinë për të negociuar për kushtet, modalitetin, si dhe për lartësinë e dënimit të përcaktuar, me të cilën, sipas shkresave të lëndës, ato janë pajtuar në marrëveshje. Gjithashtu, palët kanë mundur me vetëdashje të heqin dorë nga nënshkrimi i marrëveshjes së tillë, nëse nuk janë pajtuar me kushtet e parapara në të njëjtën.
  35. Gjykata, më tej, vëren se marrëveshja e tillë e cila është arritur në formë të shkruar i është propozuar gjykatës së shkallës së parë, e cila pastaj veprimi në pajtim me dispozitat e nenit 233 paragrafi 18 të KPPK-së, dhe përcaktoi *“se në rastin konkret parashtruesi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij.”*
  36. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesi i pakënaqur me lartësinë e dënimit të caktuar me të cilën, sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, është pajtuar vullnetarisht, i kishte ngritur në Gjykatën e Apelit, dhe më vonë në Gjykatën Supreme pretendimet për ekzistencën e *“rrethanave të reja të cilat do të mund të ndikonin në lartësinë e dënimit të shqiptuar”*.
  37. Pikërisht këto pretendime kanë qenë objekt me të cilin janë marrë Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, kur kanë konkluduar se *“...rrethanat e reja nuk janë të asaj natyre të cilat justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit...”*.
  38. Gjykata thekson se është jashtë juridiksionit të saj të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave përkitazi me vlerësimin e provave, nëse ato nuk duken si qartazi arbitrare. Gjykata tashmë vlerësoi se gjykatat e rregullta e kanë përfunduar një procedurë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të provave, në të cilën janë administruar provat e paraqitura nga mbrojtja dhe prokuroria, si dhe parashtruesit i është caktuar dënimi i cili ka rezultuar nga marrëveshja për pranimin e fajësisë.
  39. Përveç kësaj, Gjykata rithekson se detyra e Gjykatës është të vlerësojnë nëse procedurat përkatëse gjyqësore kanë qenë në ndonjë mënyrë arbitrare dhe të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, rastet: *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi për pranueshmërinë e kërkesës, të 30 qershorit 2009, paragrafi 16; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 34; *Barbera dhe Messeque Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68).
  40. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se asgjë në këtë rast të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të jetë e bindur se

thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur, apo se parashtruesit të kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, që do të kishte rezultuar me shkeljen e kësaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës ose paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

41. Gjykata konsideron se është obligim i parashtruesit të kërkesës t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë dëshminë *prima facie* e cila tregon për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në përputhje me juridiksionin e Gjykatës (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, të 5 dhjetorit 2013).
42. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* e cila tregon për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
43. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 korrik 2017, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi